

## A KUALIFIKOHEM PËR HOSPIS?

Ju kualifikoheni për hospis nëse:

- Sipas mjekut tuaj keni një diagnozë e cila do të kufizojë jetën tuaj në 6 muaj ose më pak.
- Qëllimi i kujdesit është trajtimi i simptomave dhe përmirësimi i saj në maksimum.

Shpesh, njerëzit presin shumë gjatë përpara se të flasin rreth hospis. Diskutimi rreth tij përpara se t'ju nevojitet do t'ju japë mundësinë të siguroheni që familja dhe mjekët tuaj t'i dinë dhe t'i kuptojnë dëshirat tuaja.

- Ju do të vazhdoni të merrni kujdes për problemet e tjera shëndetësore.
- Ju do të vazhdoni të merrni medikamente që ju ndihmojnë të ndiheni mirë.
- Ju do të keni mundësi të mbani kontakt me ekipin tuaj të onkologjisë dhe me mjekun tuaj.
- Ju do të merrni mbështetje emocionale, psikologjike dhe shpirtërore.
- Familja juaj do të marrë mbështetje shpirtërore dhe mbështetje për ofrimin e kujdesit.

Fokusi është tek trajtimi juaj në vend se te trajtimi i kancerit.

## KUSH DO TË KUJDESET PËR MUA GJATË QËNDRIMIT NË HOSPIS?

Një anëtar i familjes ose mik mund të jetë kujdestari juaj kryesor. Gjithashtu, gjatë qëndrimit tuaj në hospis, janë në dispozicionin tuaj profesionistët e mëposhtëm.

- Infermier
- Ndihmësinfermier
- Mjek i hospis
- Dietolog
- Punonjës social
- Këshilltar shpirtëror

## SI MBULOHEK HOSPIS?

Pjesa më e madhe e shërbimeve të hospis mbulohen nga Medicare, Medicaid dhe kompani private të sigurimit. Asnjë pacient nuk refuzohet bazuar në aftësinë e tij për të paguar. Për disa shërbime mund të duhet të paguhet një bashkëpagesë. Ekipi juaj i hospis do t'ju informojë nëse do të nevojitet ndonjë pagesë shtesë.

## ÇFARË DUHET TË DI TJETËR?

Ju mund ta anuloni atë në çdo kohë dhe për çfarëdolloj arsyeje dhe të regjistrohni sërish kur të jeni gati.

**Pyesni onkologun tuaj për informacion rreth hospis në zonën tuaj.**

Çfarë duhet  
të di për  
**HOSPIS?**







## PSE HOSPICE?

Shpesh, njerëzit presin shumë gjatë përpara se të flasin rreth hospis. Diskutimi rreth tij përpara se t'ju nevojitet do t'ju japë mundësinë të siguroheni që familja dhe mjekët tuaj t'i dinë dhe t'i kuptojnë dëshirat tuaja.

- Ju do të vazhdoni të merrni kujdes për problemet e tjera shëndetësore.
- Ju do të vazhdoni të merrni medikamente që ju ndihmojnë të ndihen mirë.
- Ju do të keni mundësi të mbani kontakt me ekipin tuaj të onkologjisë dhe me mjekun tuaj.
- Ju do të merrni mbështetje emocionale, psikologjike dhe shpirtërore.
- Familja juaj do të marrë mbështetje shpirtërore dhe mbështetje për ofrimin e kujdesit, si dhe kujdes të specializuar për të përballuar hidhërimin.

## KUR?

Ju duhet të zgjidhni hospis kur:

- Dëshironi më shumë cilësi të jetës sesa cilësi të trajtimit.
- Për ju, trajtimi është më shumë si një barrë.
- Ju dhe mjeku juaj keni arritur në përfundimin se trajtimi i kancerit nuk do të sjellë ndonjë përmirësim të rëndësishëm për ju.
- Efektet anësore të trajtimit të kancerit janë më të mëdha se dobitë.
- Ju e dini se si dëshironi ta jetoni këtë pjesë të rrugëtimit të jetës suaj.
- Keni biseduar me familjarët tuaj dhe ata respektojnë dhe mbështesin vendimin tuaj.

**Hospis ka të bëjë me cilësinë dhe kuptimin e jetës.**

## ÇFARË SHËRBIMESH MBULOHEN NË HOSPIS?

- Medikamente, pajisje dhe materiale mjekësore. Çdo medikament që ju nevojitet për t'u ndjerë mirë do të sigurohet nga hospis.
- Kujdes afatshkurtër spitalor në qendra të miratuara për simptomat që nuk mund të menaxhohen në shtëpi.
- Kujdes i përkohshëm larg shtëpisë, i quajtur gjithashtu si kujdes i përkohshëm ndihmës. Kujdesi duhet të ofrohet në një qendër të miratuar.

Shumë hospise kanë vullnetarë për të bërë shoqëri. Disa hospise ofrojnë muzikë, masazh dhe/ose terapi me kafshë shtëpiake. Bisedoni me ofruesin tuaj të hospis rreth shërbimeve më të rëndësishme për ju.

## KU OFROHET HOSPIS?

Zakonisht, kujdesi ofrohet në shtëpinë tuaj, në shtëpinë e një anëtar të familjes ose në shtëpinë e një miku. Gjatë kujdesit në shtëpi, kujdestarët tuaj mund të telefonojnë qendrën e kujdesit hospis 24 orë në ditë, 7 ditë në javë për të marrë mbështetje.

Kujdesi hospis mund të ofrohet edhe në vendet e mëposhtme:

- Shtëpi të moshuarish të pajisur me staf të specializuar (Skilled Nursing Facility, SNF)
- Qendra rezidenciale kujdesi (Assisted Living Facility, ALF)
- Qendra kujdestarie për të rriturit (Adult Foster Care, AFC)
- Shtëpi kujdesi hospis

Kur zgjidhni hospis, ju do të vazhdoni të merrni cilësinë më të lartë të kujdesit.

